



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPK IDPKI</u> Nr. I faq. Broj stranica <u>02</u> Nr. pages	Nr. Prot. Br. Prot. <u>03-02/184/17</u> Prot No. Data Datum <u>26.01.2017</u> Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.01.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4676/16, për z. Faton Grajqevci, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi, për shkak se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Faton Grajqevci, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar), në biznesin privat Sh.P.K "Vego Fresh", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Grajqevci është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragrafi 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë z. Grajqevci ka deklaruar se ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit zyrtar i lartë publik - Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi.

Ndërkohë, Agjenci kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI.03-02/48/17) me të cilën dëshmohet se z. Grajqevci ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

